



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA BULQIZE

Adresa : Lagjia Minatori Bulqize, Albania

email.bashkia.bulqize@bulqize.gov.al

Nr _____ Prot

Bulqizë, më ____/10/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: EURO-ALB shpk, me Adresë: Diber Bulqize BULQIZE Lagjia Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15.dhe me NIPT: K66613407H

Procedura e prokurimit: “Rehabilitimi i Kanalit ujitës Tuçep, Bulqizë, Proçedurë e Hapur.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-67450-07-30-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Rehabilitimi i Kanalit ujitës Tuçep, Bulqizë, kohëzgjatja 1 vit.

Publikime të mëparshme **nuk ka**:

Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 53 datë 10 Gusht 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. EURO-ALB shpk

me NIPT:K66613407H

Vlera: 107 991 769, (njëqind e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

2. PE - VLA - KU

me NIPT: K61716013M

Vlera: 99 072 827,34 (nëntëdhjetë e nëntë milion shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e shtatë presje tridhjetë e katër) lekë pa TVSH

3. 2AF ALBANIA GROUP

me NIPT: L32005501M

Vlera 108 078 928 (njëqind e tetë milion e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e tetë) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

2. PE - VLA - KU

me NIPT: K61716013M

Vlera: 99 072 827,34 (nëntëdhjetë e nëntë milion shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet e shtatë presje tridhjetë e katër) lekë pa TVSH

3. 2AF ALBANIA GROUP

me NIPT: L32005501M

Vlera 108 078 928 (njëqind e tetë milion e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e tetë) lekë pa TVSH

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

➤ PE - VLA – KU

Nga ana shoqërisë Pevlaku shpk dhe Pevlaku kosova shpk është lidhur një kontratë bashkëpunim me shoqërinë LTE Construction me numër rep 6337 dhe nr koleksioni 4148 datë 03.09.2020, sipas kontratës LTE ka marë përsipër të kryejë 30% të punimeve ndërsa shoqëria Pevlaku 70% të punimeve. Kontrata e Bashkëpunimit nuk është shoqëruar me ndarje punimesh sipas zërave të preventivit kjo ndarje nuk reflektohet as në formularin e ofertës. Referuar nenit 74 pika 1 dhe 2 të VKM nr 914 rezulton që kontrata e bashkëpunimit nuk është e vlefshme pasi duhet të bëhet ndarje e punimeve konkrete.

Shoqëria Pevlaku shpk Nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e taksave nga Bashkia Durrës për vitin 2020 referuar ekstraktit historik është shtuar adresë dytësore me date 13.08.2020, nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e taksave për vitin 2020 nga Bashkia Pogradec, referuar ekstraktit historik adresa dytësore në Pogradec është hequr më datë 02.03.2020, nuk ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Has ka hapur adresë dytësore me datë 27.09.2019 në Bashkinë Has, nuk ka paraqitur vërtetim për taksat vendore nga Bashkia Vorë është shtuar adresë dytësore në 27.07.2019, nuk ka paraqitur vërtetim për taksat e vitit 2020 nga Bashkia Tiranë

Operatori ekonomik LTE nuk ka pikat e licensës NP 1B dhe NP 7 B

Nga verifikimi i vulës apostile për kontratën e lidhur nga shoqëria Pevlaku Kosova me KRU Radoniqi sha –Gjakovë , rezulton që nuk janë reflektuar situacionet e punimeve në vulë apostile, nuk ka akt kolaudimi për punën e ngjashme të paraqitur nga ana e Shoqërisë Pevlaku Kosova

Nga ana e AK është kërkuar që operatori ekonomik të ketë jo më pak se 2 teknik ndërtimi për këtë operatori ekonomik duhet të parqesë, Diplomë të shkollës së mesme, kontratë pune të vlefshme , IQT ose ekujvalente dhe të figuroj në listëpagesën e shoqërisë, shoqëria Pevlaku shpk ka paraqitur dokumentacion si teknik ndërtimi për Z.Kadri Omeri, nuk është paraqitur diploma e shkollës së mesme, operatori ekonomik LTE ka paraqitur si teknik ndërtimi Z Enver Caushi, bashkimi i operatorëve ka vetëm një teknik ndërtimi me dokumentacion të rregullt

Nga e AK është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 2(dy) inspektorë cilësie background inxhinierik me 5 vite eksperiencë pune si inspektor cilësie në përputhje me standartin ISO 9001:2015, të figuroj në listpagesën e shoqërisë nga ana e shoqërisë Pevlaku shpk është paraqitur dokumentacion për Z.Oriol Vrekaj ing ndërtimi nuk ka paraqitur Certifikatë ISO 9001:2015 si inspektor Cilësie , ka paraqitur dokumentacion për Z. Paulin Sheperi ing ndërtimi nuk ka paraqitur Certifikatë ISO 9001:2015 si inspektor Cilësie. Inxhinieretë e mësipërm janë punonjës të shoqërisë Pevlaku Kosova operatori ekonomik nuk

ka dorëzuar listëpagesë për shoërinë Pevlaku Kosova sa më sipër nuk provohet nëse punonjësit janë të siguruar apo jo. Operatori ekonomik LTE nuk ka paraqitur dokumentacion për inspektor cilësie.

Nga ana e AK është kërkuar që operatori ekonomik të ketë jo më pak se tre automakinist për këto duhet të paraqesë, leje për drejtimin e mjeteve të rënda lëshuar nga autoritetet kompetente, kontratë pune të vlefshme iqt/ ose ekuivalente dhe të figuroj në listëpagesën e shoqërisë nga ana e operatorit Pevlaku shpk nuk është paraqitur dokumentacion për automakiniste nuk ka numërin e automakinisteve sipas përqindjes së marrë përsipër.

Nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që operatori ekonomik të ketë jo më pak se gjashtë manovrator për këto duhet të paraqes, leje për drejtimin e mjeteve të rënda lëshuar nga autoritetet kompetente, kontratë punë të vlefshme iqt/ ose ekuivalente dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë nga ana e shoqërisë Pevlaku shpk është paraqitur dokumentacion si manovrator për Z.Nikoland Ndou operatori ekonomik Pevlaku nuk ka numrin e manovratoreve sipas përqindjes së marë përsipër.

➤ 2AF ALBANIA GROUP

Nga ana e autoriteti kontraktor është kërkuar që:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :

a.Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

ose

b.Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Nga ana e operatorit ekonomik është paraqitur si punë e ngjashme kontrata e lidhur me Bashkinë Bulqizë, sipas kontratës operatori ekonomik 2AF ALBANIA GROUP ka 30% të punimeve që korrespondon vlerës prej 6971422 leke pa tvsh, nuk ka kolaudimin, nuk ka çertifikatë të marrjes në dorëzim të përkohëshme operatori ekonomik nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme.

Nga ana e AK është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë liçencë profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës të kategorive dhe niveleve:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

1. NP– 1B Punime gërmimi në tokë.
2. NP– 7B Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
3. NP 5A Punime nentokesore ura vepra arti

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS- 18 A

Operatori ekonomik nuk disponon pikat e liçencës NP 1 B, NP 7 B

Nga ana e AK është kërkuar që operatori ekonomik të disponoj 1(një) inxhinier drejtues teknik që të përmbushë kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe shëndetit gjatë realizimit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private sipas kërkesave të ligjit Nr.10237 datë 18.02.2010 "për sigurinë shëndetin në punë" dhe VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier" si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë në periudhën Mars 2020 e në vazhdim. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Nga ana e AK është kërkuar që operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë gjithashtu, stafin teknik mbështetës punonjës të certifikuar si :1 Inxhinier topograf, për të cilin të paraqitet diploma, kontrata e punës, cv dhe të figurojë në listëpagesë të shoqërisë operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për inxhinier Topograf.

Nga ana e AK është kërkuar që operatori/ët ekonomike ofertues duhet të ketë gjithashtu, stafin teknik mbështetës punonjës të certifikuar si, 2 inxhinier ndërtimi për të cilët të paraqitet diploma, kontrata e punës, cv dhe të figurojë në listëpagesë të shoqërisë . operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Nga ana e AK është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë gjashtë manovrator për këto duhet të paraqesë, leje për drejtimin e mjeteve të rënda lëshuar nga autoritetet kompetente, kontratë pune të vlefshme iqt/ ose ejkujvalente dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë. Nga ana e operatorit ekonomik është paraqitur dokumentacion si manovrator për, Sokol Durici për këtë nuk është paraqitur leje e drejtimit për mjetet të rënda.

Nga ana e AK është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë 3 murator për këto të paraqitet kontratë pune të vlefshme, iqt/ ose ekuivalente dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për murator.

Nga ana e ak është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë gjashtë shoferë kamioni për këto të paraqes leje drejtimi mjeti, kontratë punë të vlefshme, iqt/ose ekuivalente dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion për 4 shofera nuk ka numërin e kërkuar të shoferëve.

Nga ana e ak është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë 2 mekanik për këtë të paraqesë, kontratë punë të vlefshme, certifikatë/diplomë/dëshmi të aftësimit profesional, IQT/ekuivalente dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për mekanik.

Nga ana e AK është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë 1(një) specialist për punime në prani të ujit për këtë të paraqesë certifikatë/diplomë/dëshmi të aftësimit profesional IQT/ejkujvalente dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Nga ana e AK është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë 1(një) specialist për montim tubash HDPE për këtë të paraqes certifikatë/diplomë/dëshmi të aftësimit profesional IQT/ejkujvalente dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Nga ana e AK është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ketë 2(dy) inspektor cilësie background inxhinierik me 5 vite eksperiencë pune si inspektor cilësie në përputhje me

standartin ISO 9001:2015, të figuroj në listpagesn e shoqërisë, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për 2 inspektor cilësie.

Nga ana e AK është kërkuar që operatori ekonomi duhet të ketë (një) punonjës të trajnuar për të dhënë ndihmën e parë, të vertetuar me certifikatën përkatëse. Për këtë të paraqitet certifikatë trajnimi për dhënjen e ndimës së parë, kontratë pune, dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për mjete e paisje si më poshtë, Autobot uji, Betoniere kantieri 15.-3 m3. Minifadromë, eskavator me krahë të gjatë mbi 18 m , mini eskavator, tranchër, Rotary mixer.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:

EURO-ALB shpk me Adresë: Diber Bulqize BULQIZE Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit,Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15 dhe me NIPT: K66613407H se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 107 991 769,(*njëqind e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë*) lekë pa TVSH pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkisë Bulqizë lagjia "Minatori"* per sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe procedura do të anulohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë :01/10/2020

Ankesa: ka ose jo:Nuk Ka

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

Data e publikimit te ketij njoftimi: **09/10/2020**

**ZYRTARI I AUTORIZUAR
ENKELEDA LLESHI**